

Komuna e Mamushës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Mamushës është krijuar nga zonat kadastrale të Prizrenit, fillimisht si pilot njësi komunale (2005-2007) për t'u shndërruar në komunë me kompetenca të plota nga janari i vitit 2010. Komuna e Mamushës banohet kryesisht nga banorë të komunitetit turk.
2. Kryetar i kësaj komune në zgjedhjet e nëntorit të vitit 2009 është zgjedhur Arif Bütüç nga Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP). Komuna e Mamushës ka gjithsej gjashtë drejtori.
3. Kuvendi i Komunës së Mamushës përbëhet prej 15 asambleistëve, 11 prej tyre janë nga KDTP, dy përfaqësues janë nga AKR, një përfaqësues nga PDK dhe një përfaqësues ka fituar vota për të hyrë në Kuvend të Mamushës si kandidat i pavarur.
4. Në hulumtimin e zhvilluar nga UNDP i përmbledhur në "Mozaiku i Kosovës 2012" i cili pasuron opinionet e qytetarëve në lidhje me kenaqshmerine e tyre me institucionet dhe dukuritë e ndryshme në nivelin lokal, 55% e banorëve besojnë se autoritetet e tyre lokale kanë kapacitet për të zgjidhur problemet me të cilat përballet komuna e tyre, kurse 17% (në krahasim me mesataren e kosovarëve 15%) besojnë se këto probleme mund të zgjidhen vetëm nga pushteti qendror.¹
5. Në hulumtimin e bërë nga Instituti GAP në fund të vitit 2009, problemet kryesore në Komunën e Mamushës në atë kohë kanë qenë, mungesa e sistemit të ujësjellësit, kundërmimi nga lumi i fshatit, mungesa e tregut për fermerët lokal si dhe mungesa e shtëpisë së kulturës.²

¹ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. "Mozaiku i Kosovës". 2012. Fq 58
Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

² Instituti GAP. Raporti komunal. Komuna e Mamushës. 2009. Fq 3. Burimi:
http://www.institutigap.org/documents/93767_Mamusha-raporti%20komunal.pdf

Problemet kryesore në Komunën e Mamushes

- 1. Mungesa e çerdhes për fëmijë.** Komuna e Mamushës nuk ka asnjë çerdhe publike apo private. Udhëheqësit komunal në katër vitet e fundit nuk e kanë futur në prioritet ndërtimin e një çerdheje. Disa nga banorët e kësaj komune i dërgojnë fëmijët e tyre në çerdhe në Suharekë apo edhe në Prizren.
- 2. Ndotja e lumit Topulla.** Shtrati i lumit i cili përshkon Mamushën në këtë komunë është i stërm bushur nga mbeturinat dhe derdhja e kanalizimeve të cilat kundërmojnë erë të keqe. Shtrati i lumit nuk është i rregulluar. Ky problem është përmendur nga qytetarët edhe në hulumtimin e GAP bërë katër vite më parë.
- 3. Cilësia jo e mirë e ujit.** Në pjesën më të madhe të komunës së Mamushës, uji nuk përdoret për pije. Uji në rubinetet e banorëve rezulton me gëlqere dhe banorët kryesisht e blejnë ujin për pije. Sipas hulumtimit të USAID/DEMI, rreth 84% e qytetarëve në këtë komunë nuk janë të kënaqur me ujësjellësin e qytetit.³
- 4. Prezenca e mbeturinave.** Në gjithë territorin e Komunës së Mamushës vërehen grumbuj mbeturinash dhe hapësira duket e papastër. E gjithë zona përskaaj lumit Topulla është e mbushur me mbeturina. Mbeturinat vërehen edhe në parkun e vetëm të kësaj qytetëse si dhe në oborrin e shkollës fillore “Hoxhë Ymer Lutfiu”.
- 5. Dëmtimi i parkut të qytetit.** Komuna ka rregulluar parkun në qendër të qytetit, jo larg nga objekti komunal. Pjesa më e madhe e tij është e shkatërruar. Ulëset për qytetarët janë thyer, rrethojat janë larguar dhe vërehen grumbuj të mbeturinave në park. Parku është rregulluar në gjysmën e dytë të vitit 2012.

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur dhe ruajtur

- 1. Shkolla e vjetër “Hoxhë Ymer Lutfiu”.** Objekti i kësaj shkolle fillore llogaritet njëri ndër objektet më të vjetra në këtë komunë. Bashkëbiseduesit kanë kërkuar nga Komuna që kjo shkollë të shpallet si objekt i veçantë i cili duhet mirëmbajtur dhe ruajtur.


³ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 23. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

2. Festivali i domates. Komuna e Mamushës është e njohur për organizimin e “Festivalit të Domates”. Ky lloj i festivali unik në Kosovë, sipas qytetarëve, me mbështetje më të madhe nga Komuna mund të shndërrohet në festival tradicional dhe të përcillet edhe me aktivitete të tjera kulturore dhe artistike të cilat do të ndikonin në fuqizimin dhe sensibilizimin e saj.

Trendet Buxhetore në Komunën e Mamushës

Komuna e Mamushës në vitin 2013 ka planifikuar 1.1 milion euro buxhet. Krahasuar me vitin 2010, kjo komunë ka rritur buxhetin për 294 mijë euro. Të hyrat vetanake në vitin 2012 në këtë komunë kanë qenë 43 mijë euro, ndërsa krahasuar me vitin 2010 këto të hyra kanë rënë për 1 mijë euro. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm⁴ ka rekomanduar që komuna duhet: 1) të formojë një sistem automatik të faturimit; 2) të merren masa për mbledhjen e taksave dhe; 3) të bëhet barazimi në mes të departamenteve të ndryshme.

Figura 1. Buxheti i Komunës së Mamushës 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?mamushe/2013#/~/~mamushe>

⁴ ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Mamushës Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KFK_2012_Shqip_120603.pdf http://oag-rks.org/repository/docs/MAMUSHE_Report_ALB_660338.pdf

Në bazë të grafikomit rreth ndarjeve buxhetore shohim se shpenzimet kapitale dhe ato për mallra dhe shërbime kanë pasur një trend të ndryshueshëm. P.sh. pas një ngritjeje të theksueshme në vitin 2011, shpenzimet kapitale kanë rënë për 59% në vitin në vijim. Në anën tjetër, pas një rënie të theksueshme të shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vitin 2011, ato janë rritur për 93% në vitin në vijim.

Figura 2. Trendet e ndarjeve buxhetore 2010- 2012



Në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore Komuna e Mamushës 2014-2015 planifikon t'i rrisë të hyrat vetanake dhe të hyrat nga granti. Nëse krahasojmë planifikimet për vitin 2014 me vitin e tanishëm shohim se brenda një viti të hyrat vetanake pritet të rriten për 31% që vlerësohet si një rritje mjaft e theksuar.

Figura 1. Planifikimi i të hyrave vetanake dhe shpenzimeve 2014-2016

	2014	2015	2016
Të hyrat totale	1.209.609	1.242.172	1.270.465
Të hyrat vetanake	63.000	64.890	66.188
Grantet	1.146.609	1.177.282	1.204.277
Shpenzimet Totale	1.209.609	1.242.172	1.270.465
Administrata e Përgjithshme	731.792	752.478	774.607
Arsim dhe Shkenca	355.950	359.509	363.069
Shëndetësia	121.867	130.185	132.789

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe kampanjave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulamtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata të respektueshme për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Mamushës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulumtimeve më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.